

NJOFTIM PUNËSIMI

Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	<p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.</p> <p>Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vënd pune: Elektro-Pompist pranë Operimit të Rrjetit Shpërndarës në Njësinë Operative Kavajë nisur nga data më e afërt.</p> <p>Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për marrjen dhe dorëzimin e turnit duke shënuar në formatin e caktuar nga Shoqëria në librin e shënimeve, problemet e konstatuara gjatë turnit.</p>
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	<ul style="list-style-type: none">• Mban në gatishmëri dhe shfrytëzon sipas rregullave teknik stacionin e pompimit.• Për stacionet me elektrikist, lëshimi i pompave bëhet në bashkëpunim midis pompistit dhe elektrikistit. Për Stacionet pa elektrikist, pompisti manovron vetë për vënien në punë të elektro-pompave bazuar në rregulloren teknike.• Mban lidhje me Dispeçerin për probleme që dalin gjatë turnit.• Nuk largohet nga turni pa i ardhur ndërruesi.• Merr pjesë në remontet e kryera nga grupi i remonteve mekanike.• Zbaton me përpikëri Rregulloren e Sigurimit Teknik në punë. Çdo vit del para komisionit të sigurimit teknik për t’u pajisur ose rifreskuar dëshminë përkatëse. Në të kundërt i hiqet e drejta për të punuar në shfrytëzimin e elektro-pompave si pompist.• Ka për detyrë të pajiset me librezën e shëndetësisë sipas rregullave në fuqi, dhe nuk lejohet të kryejë shërbimin në stacion nëse nuk e ka plotësuar atë periodikisht.• Bën shërbimin ndaj pompave (ndërron litarët e pompave, kryen grasatimin e kushinetave,

	<p>karikimin e pompës përpara lëshimit, dhe çdo veprim tjetër sipas normave dhe rregulloreve të miratuara), mbasi është siguruar që i ka stakuar ato nga rrjeti elektrik.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxjerr jashtë pune pusët nga të cilët konstatohet së uji vjen me ndotje (i turbullt, etj.) në bashkëpunim me klorinuesin dhe njofton menjëherë Përgjegjësën e Sektorit të Transmetimit. • Administron dhe mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për inventarin e makinerive dhe pajisjeve që ka në përdorim stacioni i pompimit.
<p>Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperiencia pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
<p>Kushtet e punës:</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 29.06.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. 	